



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13336/Prot.

2

Fier, më 26.12.2024.

VENDIM

Nr. 149, Datë 23.12.2024

Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Shaqir Sulejmanaj, Lagjia “15 Tetori”, Njësia Administrative nr.3, i dëmtuar nga zjarri i datës 23.10.2024.

Në mbështetje të nenit 3, pikës 1.1 të nenit 9, dhe nenit 29 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8 dhe 16 të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, si dhe në zbatim të shkronjave “e” dhe “ë” të pikës 1, të paragrafit III, të V.K.M-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kreu III pika 1, për dëmin e shkaktuar nga zjarri i datës 23.10.2024, shkresës zyrtare nr.942/1.prot, datë 03.12.2024 “Vlerësim dëmi” të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Zhvillimit të Projekteve, Këshilli i Qarkut Fier, si dhe Preventivit bashkëlidhur kësaj shkrese, ku ka rezultuar se në banesën e shtetasit Shaqir Sulejmanaj dëmi në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake është në vlerën **578 300 (pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind) lekë** dhe në konstruksion banese, në vlerën **401 961 (katërqind e një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë**, ndaj bazuar në nenin 54, shkronja “g”, Këshilli i Bashkisë Fier,

VENDOSI:

1. Dhënie e ndihmës prej Bashkisë Fier, në masën **100%**, për dëmet e shkaktuara në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake, në vlerën prej **578 300 (pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind) lekë**.
2. Dhënie e ndihmës prej Bashkisë Fier, në masën **50%**, për dëmet e shkaktuara në anën ndërtimore të banesës, në vlerën prej **200 980 (dyqind mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë**, konform përcaktimeve ligjore të pikës 3, gërmës “ç” “Përcaktimi i ndihmës financiare” e VKM nr.329 datë 16.05.2012.
3. Vlera totale financiare e dhënies së ndihmës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij projekt vendimi për shtetasin Shaqir **Sulejmanaj** është në masën **779 280 (shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tetëdhjetë) lekë**.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit si dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT
ANTONETA ÇUNAJ**

